



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 pika 10, neni 22, neni 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019), neni 40 dhe Neni 41 i Rregullores së Punës të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) në seancën e 50 -të të mbajtur me datë 21.07.2021 të morri

VENDIM

Denoncimi i dërguar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit me numrin 08-2144 / 1 të datës 08.06.2021, nga një parashtrues i panjohur, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm sipas lëndës me numër 08-2144/1 të datës 08.06.2021.

Lënda me numër 08-2144/1 datës 08.06.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-2144 / 1 të datës 08.06.2021 është formuar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur denoncim anonim).

Me denoncimin kërkohet ekzaminim të origjinës së pasurisë së gjyqtarit _____, gjyqtari të Gjykatës Themelore _____, si dhe zyres së avokateve _____, për të cilët tregohet se veprojnë në lidhje me gjykatën dhe pas gjykimeve të rënë dakord, jepen shpenzimet të cilat ata pastaj i ndajnë përmes një llogarie transaksioni ose personalisht.

Pas shqyrtimit të pohimeve në denoncim, KSHPK -ja konstaton se pohimet e nxjerra në denoncim janë të përgjithshme dhe paushalle, duke pasur parasysh që denoncimi është dërguar nga parashtrues i panjohur i cili nuk ka dhënë detaje kontakti për qëllimin që KSHPK -ja të kërkojë pretendime shtesë, KSHPK vlerësoi se nuk kishte elemente për veprimin e saj kompetent në rastin konkret. Në bazë të theksuarës së mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: A.Ç., udhëheqës i njësisë
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHETETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska